



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 510

Datë: 08.11.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 19 paragrafi 7 pika c) të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 të datës: 14.09.2023, nenit 36 të Rregullores nr.02/175 datë:31.05.2017 për punën e kuvendit , komiteteve dhe komisioneve të Komunës së Malishevës,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –IX- (nëntë) të rregullt të mbajtur me datë: 31.10.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR.02/72 DATË:07.02.2023 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E MALISHEVËS

1.Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.02/72 datë:07.02.2023, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Malishevës.

2.Pagesa për secilin anëtarë të Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale, do të jetë në shumën 100E (njëqind euro) për çdo takim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimi të akteve të Komunës dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës





07.02.2023
02/72



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/____

Datë: 06.02.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19, Udhëzimit Administrativ nr.02/19, për Organizimin, Funksionalizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë, 30.01.2023 merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE
NË KOMUNË E MALISHEVËS

I. Me këtë vendim formohet Komisioni për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Malishevës.

I I. Mbështetur në nenin I të këtij vendimi Komisioni do të jetë në përbërje prej 7 anëtareve:

1. Halil Morina- anëtar,
2. Alban Kastrati-anëtar,
3. Argjend Thaçi -anëtar,
4. Veton Zogaj-anëtar,
5. Arben Kryeziu-anëtar,
6. Rexhep Mazreku-anëtar,
7. Një Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit Lokal.

I I I. Pagesa për anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e Këshillit Lokal do të jetë 100 euro.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa.

V. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.